

Eppc Kosovo kërkon një **Udhëheqës të Sektorit të Prodhimit** për klientin e saj, një kompani lider e cila operon në sektorin e zdrukthtarisë, që merret me aktivitete të arkitekturës, inxhinierisë, ndërtimtarisë dhe këshillimit teknik, si dhe aktivitete të tjera shërbyese në mbështetje të bizneseve.

Përgjegjësitë Kryesore:

1. Harton planin, koordinon dhe mbikëqyr procesin e prodhimit;
2. Analizon dhe kontrollon procesin në mënyrë që prodhimi të jetë i përputhshëm me kosto efektive, cilësi të lartë dhe në kohë;
3. Të monitorojë standardet e produktit dhe të zbatojë programet e kontrollit të cilësisë;
4. Të krijojë marrëdhënie ndërmjet departamenteve, si psh: arkitektëve, furnizimit, montimit;
5. Mbikëqyr, udhëheq dhe motivon punëtorët në fabrikë;
6. Përgatit targetet dhe dizenjon vlerësimin e performancës së punëtorëve;
7. Identifikon nevojat për trajnime;
8. Siguron ndjekjen e udhëzimeve për shëndetin dhe sigurinë në punë.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë universitare në zdrukthtari ose eksperiencë / njohuri ekuivalente përkatëse në fushën e ngjashme;
- Përvojë pune minimum 5 vjet në fusha të ngjashme;
- Përvojë pune minimum 3 vjet në pozitë udhëheqëse, preferohet në industri të ngjashme;
- Aftësi shumë të mira komunikimi, relacioneve me njerëz dhe prezantimi;
- Aftësi shumë të mira analitike dhe aftësi në zgjidhje të problemeve;
- Aftësi të mira kompjuterike dhe të përdorimit të makinerive në fabrikë.

Të dhënat:

Pozicioni:	Udhëheqës i Sektorit të Prodhimit;
Vendndodhja:	Prishtinë;
Paga:	Shumë konkurruese;
Kontrata:	Sipas Ligjit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	17.06.2018.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke përmendur pozicionin **“Udhëheqës i Sektorit të Prodhimit”** në subject në adresën e e-mail^{it}:

kosovo@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.